

DEKRET
Nr. 458, datë 5.12.2025

PËR DHËNIE DEKORATE

Në mbështetje të nenit 92, germa “ç”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 6, pika 1, të ligjit nr. 93/2022, “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

**Dhënien e dekoratës “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut”
zotit Kastriot Aliko**

“Në vlerësim të angazhimit 30-vjeçar të një mësuesi dhe të një njeriu shembullor që i ka kushtuar një pjesë të jetës së tij, në kushte të vështira e me një këmbëngulje heroike, mësime dhe nxënësi të vetëm, me aftësi ndryshe, në shkollën e fshatit Vodicë, shumë kilometra larg vendbanimit të tij, duke dëshmuar dashuri dhe përkushtim të rrallë, frymëzuese për të gjithë”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj